

**LIGJ**  
**Nr. 109/2020**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 4/2020, “PËR  
SHKËMBIMIN AUTOMATIK TË INFORMACIONIT TË LLOGARIVE  
FINANCIARE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 4/2020, “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 11 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Përjashtimisht për shkëmbimin e parë automatik, autoriteti kompetent shkëmben informacion me juridiksionet e tjera kompetente brenda datës 31.12.2020.”.

**Neni 2**

Pika 1 e nenit 19 ndryshohet si më poshtë:

“1. Përjashtimisht për raportimin e parë, institucioni financiar raportues, pas aplikimit të procedurave të vigjilencës së duhur, raporton brenda datës 15 nëntor 2020 për të gjitha llogaritë e raportueshme ekzistuese në datën 1.1.2019, si dhe llogaritë e raportueshme të hapura përgjatë vitit 2019, sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji.”.

**Neni 3**

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 29.7.2020.

**Shpallur me dekretin nr. 11583, datë 5.8.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Ilir Meta**

**Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 146, datë 07.08.2020**